**Të nderuar,**

TRAJNIMET për Mbikëqyrës fillojnë më **18-22 mars 2024**, derisa trajnimet për REGJISTRUES do të mbahen nga 25-29 mars 2024.

Trajnimet janë në nivel rajonal. Prandak, jo të gjithë Mbikëqyrësit do t'i mbajnë trajnimet në komunat e tyre.

Për lokacionin e trajnimeve luteni ta shikoni dokumentin "Sallat e trajnimeve për Mbikëqyrës".

**Për ta nënshkruar kontratën me ASK-në, të gjithë Mbikëqyrësit duhet ta nxjerrin ''Vërtetimin e të kaluarës kriminale'' që mund të nxirret në platformën elektronike "eKosova". Kontratat do të nënshkruhen pas trajnimeve, më 22 mars 2024.**

Për nxjerrjen e Vërtetimit nga platforma duhet ndjekur këta hapa:
Pasi keni hyrë në eKosova https://ekosova.rks-gov.net/ duhet të shtypni në fushën lartë tek ''**Shërbimet",** pastaj kaloni tek fusha **''Policia''.** Pasi të jetë hapur kjo fushë, shtypeni **''Vërtetimi i të kaluarës kriminale''**. Vazhdoni me opsionin *Regjioni* (pra nga cili regjion jeni) pastaj tek *Stacioni* ju duhet ta caktoni një stacion policie, që është më afër vendbanimit tuaj.

Pas kësaj, tek fusha **''Arsyet''** hapeni këtë fushë, ku shihen opsionet dhe ju duhet ta zgjidheni opsionin ***''REGJISTIRMI I POPULLSISE''.***

Tek deklarata mund të shkruani: Vërtetimi me nevojitet pasi kam aplikuar si: Mbikëqyrës ose Regjistrues. Në fund e dërgoni kërkesën.

Pasi ta keni dërguar kërkesën, ju mund ta merrni vërtetimin brenda 24 orëve.

*Në rast se nuk e merrni brenda 24 orëve, luteni ta kontaktoni Stacionin policor të zonës suaj.*

***Vërtetimi është I obligueshëm dhe duhet ta sillni në ditët gjatë trajnimit, mundësisht në ditën e parë ose të dytë të trajnimit.***